PROCEDURAT E APLIKIMIT DHE TË REGJISTRIMIT TË KANDIDATËVE ME STATUSIN E PERSONIT ME AFTËSI TË KUFIZUAR, ME STATUSIN E JETIMIT, SI DHE TË KANDIDATËVE TË PAKICAVE ROME DHE EGJIPTIANE

- **Program i Integruar i studimit të ciklit të dytë, Master Shkencor në Arkitekturë, Profili Urbanist**

Kandidatët me statusin e personit me aftësi të kufizuar, me statusin e jetimit, si dhe të kandidatëve të pakicave rome dhe egjiptiane duhet të paraqesin pranë sekretarisë mësimore dokumentacionin e mëposhtëm:

a) Formularin e aplikimit sipas formatit të shtojcës nr. 2
b) Kopje të diplomës/dëftesës, të shoqëruar me listën e notave
c) Në momentin e regjistrimit kandidati fitues duhet të dorëzojë pranë IAL-së. Deklaratën sipas shtojcës nr. 1 si dhe diplomën e Maturës Shtetërore së bashku me certifikatën e notave ose të një dëftese/diplome tjetër studimi të fituar jashtë vendit. Kandidati që ka përfunduar shkollën e mesme në Republikën e Shqipërisë përpara vitit 2011, të dorëzojë kopje të njësuar me origjinalin e dëftesës së pjekurisë të shkollës së mesme
d) Kopje të dokumentit të identifikimit
e) Dy fotografi personale
f) Kopje të mandatpagesës

*Kandidati me statusin e **personit me aftësi të kufizuar**, përveç dokumentacionit të mësipërm duhet të dorëzojë kopje të njehsuar me origjinalin të vendimit të Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë (KMCAP) ose kopje të njehsuar me origjinalin të librezës përkatëse të lëshuar nga Shërbimi Social Shtetëror.*
*Kandidati me **statusin e jetimit** përveç dokumentacionit të mësipërm duhet të dorëzojë edhe kopje të njehsuar me origjinalin të dokumentit që certifikon statusin e jetimit të lëshuar nga Shërbimi Social Shtetëror.*
*Kandidati që i përket **pakicave rome apo egjiptiane**, përveç dokumentacionit të mësipërm të këtij kreu duhet të dorëzojë edhe vetëdeklarim ose një dokument që vërteton përkatësinë në pakicën rome apo egjiptiane.*

Shënim:

Kandidati paraqitet personalisht ose nëpërmjet personit të autorizuar prej tij me prokurë.